

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-154/13

Prishtinë,

10 dhjetor 2013

Në çështjen juridike të

Q.G

R.G

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA 1182) të datës 13 shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 10 dhjetor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Hedhet poshtë si papranueshme ankesa e Q.G kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013, i datës 13 shkurt 2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA1182.
2. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R.G kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013, i datës 13 shkurt 2013 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA1182.
3. Konfirmohet vendimi KPCC/D/A/188/2013, i datës 13 shkurt 2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA1182.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 31 tetor 2007, Q.G ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar pronësinë dhe kthimin në posedim të një pjesë të ngastrës nr. 704/5, në rrugën “Skenderbeu”, Fleta Poseduese 1381, në sipërfaqe prej 0.23.78 ha, arë, Zona Kadastrale e Isogut, Komuna e Istogut.
2. Më 24 tetor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) e ka hedhur poshtë kërkesën me vendimin grupor. Në paragrafin 18 në vendimin grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar të datës 13 shkurt 2013 vlen posaçërisht për këtë kërkesë, thuhet se sipas dokumenteve të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës e të cilat janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive apo janë konfirmuar nga paraqitësit i kërkesës, paraqitësit i kërkesës nuk ka arritur që të tregoj se kërkesa e tij ka të bëjë me rrethanat që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur i viteve 1998-1999. Në këtë mënyrë, kërkesa është konsideruar se ishte jashtë mandatit të Komisionit dhe ishte hedhur poshtë.
3. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar Q.G më 30 korrik 2013. Q.G dhe vëllai i tij R.G e kanë kundërshtuar vendimin më datën 2 gusht 2013. R.G nuk ka qenë palë në procedurën pranë AKP-së, por ai në kërkesë ishte cekur si “palë tjetër si personi fizik në kërkesë”.
4. Asnjë palë kundërshtare apo palë përgjegjëse në kërkesë nuk është identifikuar nga KKPK-ja apo nga Gjykata Supreme.

5. Gjykata e ka pranuar dosjen e lëndës më 25 nëntor 2013.

Pretendimet e palëve ankuese

6. Q.G dhe R.G deklarojnë se vendimi i marrë nga KKPK-ja bazohet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe në zbatimin e gabuar të dispozitave relevante ligjore.
7. KKPK-ja nuk ka marrë parasysh se Komuna e Istogut e ka eksproprijuar pronën në vitin 1983. Qëllim i eksproprijimit ishte që të ndërtohej në stacion i autobusëve. G. iu ishte premtuar tokë si kompensim, por ajo asnjëherë nuk iu ishte dhënë atyre. Atyre nuk iu është dhënë ndonjë kompensim monetar dhe tani kërkesa për kompensim arrin në 460 000 EUR.
8. Sipas kadastrit, prona ende ishte e regjistruar në emër të Q.G dhe R.G.

Arsyetim ligjor

9. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditës të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (tani e tutje Ligji Nr. 03/L-079).
10. R.G nuk ka qenë palë në procedurën pranë KKPK-së. Neni 12.1 i Ligjit Nr. 03/L-079 thekson se “pala mund të paraqes” ankesë. Nuk ka ndonjë indikacion se R.G nuk ishte në dijeni të procedurës. Sipas këtyre rrethanave, sipas praktikës së Gjykatës Supreme, dmth. vendimit GSK-KPA-A-140/2013, dhe sipas nenit 13 paragrafi 3 (b) të Ligjit Nr. 03/L-079, ankesa duhet të hedhet si e papranueshme.
11. Ankesa e Q.G është e papranueshme.
12. Megjithatë, Gjykata Supreme pajtohet me KKPK-në se kërkesa nuk është në juridiksion të KKPK-së e në këtë mënyrë as në juridiksion të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme po ashtu pajtohet plotësisht me arsyen e dhënë nga KKPK-ja.
13. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për të zgjidhur kërkesat që ndërlidhen me konfliktin e që kanë të bëjnë me pronësinë apo të drejtat pronësore ndaj pronës së paluajtshme private duke përfshirë edhe pronën bujqësore dhe atë komerciale. KKPK-ja është

kompetent vetëm nëse kërkesat janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

14. Në rastin e tanishëm, G. pretendon se prona ishte eksproprijuar në vitin 1983. Është e qartë se kërkesa ka të bëjë me një kontest që kishte filluar para vitit 1998 dhe se nuk ka lidhje dhe nuk rezulton nga konflikti i armatosur i viteve 1998/1999.
15. Prandaj, kërkesa është papranueshme për shkak të mungesës së juridiksionit. Ankesa është pabazuar dhe Gjykata Supreme e refuzon ankesën dhe e konfirmon vendimin e KKPK-së (neni 13 paragrafi 3 (c) i Ligjit Nr. 03/L-079).
16. Pasi që KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme nuk kanë juridiksion në këtë rast, as KKPK-ja e as Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme nuk i ka shqyrtuar meritat e lëndës, për të cilat do të duhej të vendosej në mënyrë të pavarur nga gjykatat e rregullta në Kosovë.

Këshillë ligjore

17. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit Nr. 03/L-079 ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it